
REFERATE E KUMTESA

MUHAMET QERIMI**NDIKIMET DHE RIVALITETET FETARE MIDIS ROMËS
DHE BIZANTIT NË TROJET SHQIPTARE****Abstrakt**

Treva iliro-shqiptare e vendosur mes Lindjes ortodokse dhe Perëndimit katolik ishte hapësirë ku u zhvilluan rivalitetet e përhershme brendafetare. Si pasojë e këtyre zhvillimeve shqiptarët e atëhershëm u ndanë në dy rite të krishtera, katolike e ortodokse, me përhapje më të madhe të së dytës. Ata u bënë protagonistë të këtyre ngjarjeve fetare shumë më përpara fqinjëve të ardhur sllavë, bullgarëve apo serbëve, të cilët krishterimin e pranuan shumë vonë (shek. IX dhe X), kur tradita e krishterë shqiptare kishte kaluar një rrugë të gjatë. Popullsia iliro-shqiptare, pavarësisht rivaliteteve fetare brendakrishtere, ruajti identitetin e saj etnik. Ky identitet shqiptar u ruajt edhe në rrethanat e vështira pasbizantine, kur shqiptarët u përfshinë në procesin e gjatë të konvertimit në islam, dhe kur tabloja fetare e shqiptarëve u bë më specifika ndër popujt e Ballkanit.

....

Iliria, krahas Greqisë dhe Romës, ishte ndër vendet më të hershme të Evropës që e përqafoi krishterimin si vlerë shoqërore dhe fetare. Ndarja e Perandorisë Romake në dy pjesë mbarti frymën e ndarjes edhe në aspektin kishtar, por me një vonesë disashekullore. Deri në shek. VIII organizimi i kishës së krishterë në Iliri ishte direkt nën varësinë e Romës. Kjo vartësi kishtarë shërbeu si shkak që terminologjia e kishës në Iliri i përket kryesisht traditës latine, siç mund të vërehet edhe tek shprehjet *meshë, kungatë, prift, shenjtë, pagëzim, peshkop, kryq, mallkim* etj. Ky fakt dëshmon për autoktoninë, prezencën dhe kontaktet e ilirëve me botën fetare e kulturore latine edhe gjatë shek. IV-V, kur edhe u sanksionua gjuha latine e kishës, ceremonitë dhe terminologjia fetare. Nëse i kthehemi në fillim origjinës së krishterimit mund të themi se atë e kemi prezent në trevat ilire që në kohën apostolike (shek. I erës sonë) si fe

ilegale. Gjurmët e kësaj prezence i hasim përmes veprimtarisë së Shën Palit apostull me shoqëruesit e tij, të cilët zbritën në Apoloni për t'u shpërndarë në Ilirik, Epir e Maqedoni.¹ Falë aktivitetit të përkushtuar dhe të vazhdueshëm të bashkësive të para të krishtera qysh në gjysmën e parë të shek. IV, krishterimi u bë fe zyrtare nga shteti romak. Ky triumf nuk ishte i njëtrajtshëm por u zhvillua gradualisht në kohë dhe hapësirë. Kësisoj në zonën bregdetare të Ilirisë krishterimi triumfoi përfundimisht në shek II-IV, kurse në zonat e brendshme në shek IV-VI.² Gjatë Antikitetit të Vonë, kur dyndjet e popujve u bënë rrezik për Perandorinë Romake, kulturën dhe qytetërimin antik sidomos për pjesën perëndimore, krishterimi u bë një faktor i rëndësishëm i qëndresës së popullsisë vendase ndaj popujve të ardhur.³

Në këtë periudhë strukturat kishtare në Iliri u organizuan mbi bazën e provincave të Dardanisë, të Prevalit dhe të Epirit, të cilat shërbyen si bazë edhe për organizimin fetar. Pas shpalljes së krishterimit si fe zyrtare në Perandorinë Romake, nga ana e perandorit Teodos u themeluan peshkopatat e para në Iliri.⁴ Këto peshkopata, pas ndarjes së Perandorisë u përfshinë në zonën e Ilirikut Lindor, varësia kishtare e të cilit ka lëvizur midis Romës dhe Kostandinopojës. Tokat ilire shërbyen si kufi ndarës midis katolicizmit dhe ortodoksisë duke i ndarë edhe ilirët në pjesëtarë të këtyre dy feve. Trevat ilire që nga viti 395, kur u nda Perandoria Romake në dy pjesë dhe deri në shek VI, edhe pse nga ana politike bënë pjesë në Perandorinë Bizantine, nga ana fetare ishin kryesisht të lidhura me Romën. Rol të rëndësishëm në këtë drejtim ka ushtruar perandori Justinian.⁵ Përkundër organizimit fillestar mjaft të suksesshëm, kisha e krishterë nuk mundi ta ruajë unitetin për një kohë të gjatë. Fërkimet e para midis kishës së Lindjes dhe asaj të Perëndimit ndodhën gjatë

¹ Radomir Popovic, *Le christianisme sur le sol de l'Illyricum oriental jusqu'à l'arrivée de slaves*, Institute for Balkan Studies, Thessaloniki: 1996, f. 21-27; Bernard Bavant, *L'Illyricum, dans Le Monde Byzantin I, L'Empire romain d'Orient (330-641)*, Presses Universitaires de France, Paris: 2004, f. 318-320; Petrika Thëngjilli, *Shqiptarët midis lindjes dhe perëndimit 1506-1839 (Fusha Fetare)*, Tiranë: Maluka, 2002, f. 13.

² Myzafer Korkuti, *Parailirët, Ilirët, Arbërit*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: 2003, f. 80.

³ *Po aty*, f. 81.

⁴ Kristo Frashëri, *The History of Albania*, Tiranë: 8 Nëntori, 1964, f. 30.

⁵ Pëllumb Xhufi, "Krishterimi roman në Shqipëri në shek VI-XVI", në simpoziumin *Krishterimi ndër shqiptarë*, Tiranë, 16-19 nëntor 1999, Shkodër: 2002, f. 189; Gasper Gjini, *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*, Ferizaj: Drita, 1992, f. 23.

“skizmës akaciane” (484-519).⁶ Pas këtyre përplasjeve fillestare, të parët ishin peshkopët e Durrësit që mbajtën qëndrim pro Kostandinopojës.⁷ Megjithatë, deri në shek. VIII krishterimi në Iliri formalisht iu referua Romës. Por, prej gjysmës së parë të shek. VIII (viti 732 pas vendimit të Perandorit bizantin Leoni III Isaurit për ndarjen e dioqezave të Lindjes nga ato të Perëndimit)⁸ dhe deri në shek. X, hapësira ilire (tashmë e njohur si vend i shqiptarëve) u nda në zona që vareshin nga Patrikana e Kostandinopojës (të cilat përbënin shumicën absolute) dhe në të tjerat (një pjesë e vogël) që vareshin nga Roma.⁹ Për herë të parë, riti lindor apo ortodoks u përhap në shek. IX (870), por përhapjen më të madhe e pati në shek. X, kur mitropolia e Durrësit shtrihej nga Tivari në Vlorë dhe kishte nën vartësi 15 seli peshkopale: Tivar, Lyknid, Shkodër, Drisht, Diokle, Pult, Lezhë, Krujë, Stefaniakë, Kunavi, Cërnik.¹⁰ Ishte kjo periudhë kur Kisha e Kostandinopojës arriti shtrirjen më të madhe në trojet shqiptare.

Në shek. XI kisha latine u riafirmua në Shqipërinë e Veriut nëpërmjet degëzimeve të skajshme dalmatinase.¹¹ Midis enklavave që ruanin lidhje solide me Romën ishte edhe provinca e Prevalit me qytetet: Shkodër, Drisht, Danjë, Shas, Tivar dhe Ulqin. Mendohet që lumi i Matit të ketë qenë vijë ndarjeje ndërmjet Bizantit dhe Romës. Kjo ndarje e asaj kohe do të përcillet dhe do të ruhet pothuajse gjatë tërë rrjedhës pasuese të historisë, madje deri sot, nëse nuk e llogarisim islamin si fe që erdhi më vonë në këto hapësira. Në kulmin e periudhës bizantine, shek. XI, kur shqiptarët shfaqen për herë të parë me emër në literaturën historike, kronisti M. Ataliati pohonte se ky popull ishte “bashkëfetar” me bizantinët.¹² Duke iu referuar shek. X-XI tokat shqiptare ishin nën

⁶ Për më tepër shih: Averel Cameron, *The Cambridge Ancient History*, volum XIV, Cambridge University Press, Cambridge: 2000, f. 79-82.

⁷ P. Thëngjilli, *Shqiptarët midis lindjes dhe perëndimit...*, f. 13.

⁸ Jens Reuter, *Shqiptarët në Jugosllavi*, Tiranë: Botimpex, 2003, f. 12.

⁹ Christia Fraisse-Coué, “L’incompréhension croissante entre l’Orient et l’Occident (451-518)”, in *Histoire du christianisme III. Les Elgises d’Orient et d’Occident (432-610)*, tome III, Desclée, Paris: 1998, f. 175; M. Korkuti, *Parailirët, Ilirët, Arbërit...*, f. 80.

¹⁰ J. Durrauzes, *Notitiae Episcopatum Ecclesiae Constantinopolitanae*, Paris: 1981, f. 330; P. Xhufi, “Krishterimi roman në Shqipëri në shek VI-XVI...”, f. 91-92; P. Thëngjilli, *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit...*, f. 14.

¹¹ Roberto Moroco della Roka, *Kombësia dhe feja në Shqipëri, 1920-1944*, Tiranë: Elena Gjika, 1994, f. 66.

¹² Pëllumb Xhufi, “Ndjenja fetare në Shqipëri gjatë mesjetës”, në *Studime historike*, nr. 1-4, Tiranë: 1997, f. 6.

juridiksionin e tre kryepeshkopatave: e Naupaktit, e Durrësit dhe e Ohrit. Në rivalitetin midis tyre ishte ajo e Ohrit që po fitonte më shumë nga hapësira shqiptare. Disa peshkopata si ajo e Himarës, Butrintit, Drinopojës, Kozilit (pranë Prevezës) dhe ato të Vlorës, Glavinicës (Ballshit), Cërrikut, u shkëputën nga kryepeshkopatat e Naupaktit dhe të Durrësit dhe u bashkuan me atë të Ohrit.¹³ Pas ndarjes së parë të krishterimit (skizma Fotjus e shek. IX)¹⁴ dhe sidomos pas skizmës së madhe të vitit 1054, në Shqipëri u përvijuan dy zona rituale: zona katolike/romane në veri dhe zona bizantine/ortodokse në qendër dhe jug.¹⁵ Kjo ndarje e madhe e kishës (Lindore dhe Perëndimore) u diktua nga procese historike, si prezenca e normanëve apo anzhuinëve. Veçanërisht në periudhën 731-1054, por dhe në vazhdim, nga shqyrtimi i një baze të gjerë dokumentare arkivore vërehet një konkurrencë periodike ndërmjet Romës dhe Kostandinopojës, për të pasur nën influencë dioqezat e Ilirisë/Shqipërisë. Rivaliteti arriti deri në beteja të përgjakshme. Në këtë rrafsh duhet përmendur tkurrja e hapësirave që ishin nën juridiksionin e kryepeshkopatës së Durrësit në favor të Kishës Katolike. Nëse do t'u referoheshim të dhënave faktike do të thoshim se në vitin 1143 nën juridiksionin e Durrësit ishin katër sufragane (ipeshkvi të varura nga një seli më e lartë) nga 14 që ishin më parë.¹⁶ Një pjesë e tyre, kaloi nën juridiksionin katolik (peshkopata e Ulqinit degë e Tivarit në vitin 1022)¹⁷. Pra, po zhvillohej një tendencë në rritje për shkëputje nga Patrikana dhe njëherazi për përfshirje nën juridiksionin katolik. Megjithatë, procesi i kalimit nga juridiksioni ortodoks në atë katolik ose anasjelltas qe i gjatë në kohë. Kjo vërehet dhe në aplikimin e riteve dhe të terminologjisë, të cilat tregojnë se në shek. VI-XI, kishat e Ilirikut afroheshin më shumë me kishën romane¹⁸.

Për këtë ndikoi edhe depërtimi i bullgarëve në viset shqiptare. Ai izoloi përkohësisht këto hapësira për shtrirjen e Patrikanës, por krishterimi ortodoks u ruajt nga vendasit. Për më tepër mbreti i

¹³ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI – vitet 20 të shek. XIX) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002, f. 245.

¹⁴ Për më tepër shih P. Xhufi, "Krishterimi roman në Shqipëri...", f. 89-97.

¹⁵ P. Xhufi, "Ndjenja fetare...", f. 6.

¹⁶ *Historia e popullit shqiptar...*, vëll. I, f. 245.

¹⁷ Milan Shuflaj, *Serbët dhe shqiptarët*, Tiranë: Bargjini, 2001, f. 182.

¹⁸ Zhan Klod Faverial, *Historia më e vjetër e Shqipërisë*, Tiranë: Plejad, 2004, f. 44.

bullgarëve, Borisi, në vitin 866 u pagëzua në tokën shqiptare (kishën e Ballshit). Bullgaret nga paganë u bënë të krishterë. Borisi, pas kësaj, duke kuptuar rëndësinë e fesë në trevat e pushtuara kërkoi të lidhej me papën e Romës për të kërkuar udhëzime për një administrim kishtar të saktë. Autorë të ndryshëm i përmbahen mendimit se Borisi duhej t'i drejtohej Kostandinopolit. Por, kur Borisi ishte pagëzuar në ato toka, ku krishterimin e kishte sjellë vetë Shën Pali (kishte predikuar Ungjillin e popujve të Skithisë, Ilirisë dhe Epirit)¹⁹ ishte e natyrshme që ai t'i drejtohej Romës, si kryeqendra e parë zyrtare e krishterimit. Armiqësia e Kostandinopolit me mbretërit bullgarë vazhdoi dhe arriti kulmin më 1014 kur Samueli u mund nga perandori i Bizantit, Vasili II. Ky i fundit riorganizoi Peshkopatën e Ohrit, duke vënë në krye peshkopë grekë si Theogilikati më 1100 me synimin për të përfshirë të gjithë Shqipërinë dhe Italinë e Jugut. Ndërkohë Patrikana e Romës, ose Papati (influcencë franceze) vazhdoi, deri në vitin 1303 të intensifikojë luftën për të fituar sa më shumë dioqeza në Dalmaci dhe Shqipëri. Ky mision iu besua kryesisht peshkopëve të Raguzës, të cilët morën masa ndaj disa priftërinjve të Ulqinit (1167), dhe të Tivarit (1303) të cilët predikonin sipas riteve të kishës së Lindjes. Zbarkimet e normanëve më 1081 dhe më 1105 si dhe zhvillimi i kryqëzatës së parë më 1096 shkaktuan lëkundje për unifikimin e kishës së krishterë. Pushtimi i Kostandinopojës më 1204 nga Kryqëzata IV dhe mbajtja e saj për 60 vjet nën sundimin francez, sollti edhe murgjit francezë benediktinë në Shqipëri (1230). Ata u vendosën fillimisht në Shirgj (mbi Bunë)²⁰ dhe më vonë në Durrës dhe Shkodër (pas viteve 1250) nën mbrojtjen e Karlit Anzhu. Po në këtë kohë (1283)²¹ u vendos edhe Urdhri i Françeskanëve, duke thelluar procesin dhe kthimin e shqiptarëve të krishterë tek qendra e vjetër, Roma. Këto zhvillime i përkrahu edhe Principata e Shqipërisë më 1208. Kjo dëshmohet nga letërkëmbimi i Dhimitrit (princit të Shqipërisë) me papa Inocentin III, ku i shfaqte kreut të Kishës Katolike vendimin për t'u futur bashkë me vasalët e tij në gjirin e Kishës Katolike.²²

Pavarësisht nga veprimi intensiv i Kishës Katolike, në jug të vijës Durrës-Ohër, pozitat e Kishës Ortodokse nuk u rrezikuan asnjëherë. Qendrat e mëdha ortodokse bizantine vepronin dhe punonin në mënyrë

¹⁹ *Po aty*, f. 79.

²⁰ M. Shufllaj, *Serbët dhe shqiptarët...*, f. 210.

²¹ *Po aty*, f. 213.

²² *Histori e popullit shqiptar...*, f. 249.

intensive. Midis tyre duhen përmendur peshkopatat e Durrësit, Neupaktit dhe Ohrit. Një numër i madh kishash e manastiresh (në jug të vijës së përmendur) ofrojnë mjaft dëshmi që hedhin dritë mbi ndikimin e madh të Kishës Ortodokse Bizantine. Disa prej manastireve administroheshin direkt prej patrikut të Kostandinopojës si manastiri i Shën Kollit (në Mesopotam të Delvinës), manastiri i Labovës së Kryqit (Gjirokastrë), manastiri i Hotovës (Çamëri).²³ Në viset shqiptare që ishin nën juridiksionin kishtar të Patrikanës, nuk u ndie shumë kriza që pësoi Perandoria Bizantine pas luftërave kryqtare dhe shembjes së saj më 1204. Kjo sepse gjithë territoret prej Durrësit në Prevezë, u përfshinë në kufijtë e Despotatit të Epirit. Ky formacion në pikëpamje shtetërore e kishtarë, në një farë mënyre, një imitim i Perandorisë Bizantine. Krahas kësaj, duhet marrë në konsideratë fakti që pjesa më e madhe e këtyre trevave në periudhën 1260-1346 u përfshinë në kuadrin e Perandorisë së rindërtuar Bizantine.²⁴ Kjo ndikoi në forcimin e besimit ortodoks. Në përgjithësi trevat jugore shqiptare dhe banorët e tyre qëndruan të lidhura me ritin ortodoks. Edhe pse tokat dhe popullsia shqiptare në shek. XI-XV, u përfshinë në dy përkatësi fetare (ortodokse e katolike), nuk arriti asnjëherë të kishte karakter të jotolerancës e të fanatizmit fetar. Nuk gjenden të dhëna historike që të dëshmojnë ekzistencën e konflikteve fetare midis shqiptarëve ortodoksë dhe atyre katolikë. Tokat shqiptare në shek. X-XV u karakterizuan nga paqëndrueshmëri të natyrave politike e fetare në kuptimin e jashtëm por, kjo gjë nuk u shpreh me përçarjen e brendshme shqiptare.

Pas shembjes së Perandorisë Serbe dhe asaj Bizantine, ortodoksia humbi përfundimisht mbështetjen politike. Për rrjedhojë, katolicizmi pati shtrirjen më të madhe. Katolike ishin rajonet e Pultit, Arbërisë dhe të Kandavisë, veçanërisht familjet princore të Topisë, të Krujës, Kaninës, Muzakajve, Shpatajve, Zenebishëve, Balshajve, Arianitëve.²⁵ Edhe antroponimia e pranishme në regjistrat e Delvinës, Janinës, Vlorës të vitit 1583²⁶, janë dëshmi e kësaj dukurie.

Ndërkohë që papa dhe patriku luftonin në Ballkan për hegjemoni dalin në skenë turqit osmanë, të cilët pushtuan Ohrin në vitin 1408,

²³ *Po aty*, f. 251.

²⁴ *Po aty*.

²⁵ D. Shan Zefi, *Islamizimi i shqiptarëve gjatë shekujve*, Prizren: Drita, 2000, f. 51.

²⁶ Më gjerë shih Petrika Thëngjilli, "Disa aspekte të kombësisë shqiptare në burimet osmane të shek. XV-XVI", në *Studime historike*, nr. 1, Tiranë: 1981, f. 177-193.

Kostandinopojën më 1453, dhe Tivarin (qendër që varej nga Roma) më 1571. Pushtimi osman e gjeti Shqipërinë në tri rajone të mëdha: katolik në Shqipërinë e Veriut, ortodoks në Shqipërinë e Jugut dhe ndërmjetme në Shqipërinë e Mesme, ku depërtoi më herët islami. Fakti që u lidh një traktat ndërmjet Sulltan Mehmetit II dhe patrikut të ri të Patrikanës Gjergj Skelari, në të cilin u ra dakord që mos të prisheshin kishat për t'u bërë xhami, martesat dhe funeralet të bëheshin në kishë dhe të mos prishej festa e Pashkëve krijoi përparësi që ortodoksizmi vazhdoi të mbijetonte në tokat shqiptare.

Në fund, arrijmë në një konkluzion se treva e Ilirisë si zonë kufitare midis Lindjes ortodokse dhe Perëndimit katolik ishte hapësirë ku u zhvilluan rivalitetet e përhershme brendafetare. Si pasojë e këtyre zhvillimeve shqiptarët e atëhershëm u ndanë në dy religjione por e ruajtën identitetin e tyre etnik. Ata ishin shumë herët protagonistë të këtyre ngjarjeve fetare madje, në këtë kontekst, ishin shumë më para fqinjëve të ardhur sllavë, siç është rasti i bullgarëve apo serbëve, të cilët krishterimin e pranuan shumë vonë (shek. IX dhe X) në kohën kur tradita e krishtere shqiptare kishte kaluar një rrugë të gjatë dhe ku e priste edhe një rrugë tjetër më e gjatë, ajo e konvertimit fetar në islam që do ta bëjë edhe më specifike tablonë fetare të shqiptarëve.

